



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 345/4 Prot.

Tiranë, më 11 / 5 /2018

**V E N D I M**

**Nr. 120 , Datë 11 / 5 /2018**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 35, datë 08.03.2018, të paraqitur nga Shoqata “Lëvizja Rinore Egjiptiane-Rome” kundër Këshillit Bashkiak Lushnjë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “racës”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

Sipas informacionit të dhënë, në formularin e ankesës, subjekti ankues deklaroi se: *“Këshilli Bashkiak Lushnjë me Vendimin nr.15, datë 26.01.2018 ka miratuar akordimin e fondit për botimin e një libri të titulluar “Dashuria e një jevge”. Ky titull përmban një term pejhorativ që përdoret për të etiketuar komunitetin egjiptian. Këshilli Bashkiak si institucion publik nuk duhet të lejojë përdorimin dhe të financojë një botim që përmban këtë fjalë në titull”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që të ndalohet hyrja në fuqi e vendimit të Këshillit Bashkiak.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi për shkak të racës është shkak i mbrojtur nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, dhe bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

*Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:*

- Me shkresën Nr. 345/1 prot, datë 13.03.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga ana e Këshillit Bashkiak Lushnjë, lidhur me ankesën e bërë nga shoqata LRER.

Me shkresën nr. 1830/1 Prot, datë 15.03.2017 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Këshilli Bashkiak Lushnjë, në mes të tjerash informon se: *“Këshilli Bashkiak Lushnjë në mbledhjen e datës 26.01.2018 ka marrë në shqyrtim disa projektvendime të ardhura nga Kryetari i Bashkisë Lushnjë, ndër të tjera dhe projektvendimi mbi përdorimin e fondit rezervë për librin “Dashuria e një jevge”. Projektvendimi pasi ka kaluar dhe kryesinë e Këshillit është paraqitur për miratim në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, ku është miratuar. Më pas bazuar në nenin 16 të ligjit 107/2016 për “Prefektin e Qarkut”, vendimet e Këshillit dërgohen në Prefekturë për ligjshmërinë e tyre. Vendimi nr.15, datë 26.01.2018 “Mbi përdorimin e fondit rezervë për librin “Dashuria e një jevge” nuk është konfirmuar, në përputhje me nenin 6 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe si rezultat ky vendim nuk është i zbatueshëm. Përsa e përket titullit të librit, është marrë informacion nga autori në momentin e shqyrtimit nga Kryesia e Këshillit dhe në mënyrë absolute nuk ka qëllim pezhorativ por e kundërta është e vërtetë, pasi autori gjatë jetës së tij ka punuar me këtë komunitet dhe ka gëzuar respektin maksimal. Duke u nisur nga kjo marrëdhënie autori ka shkruar edhe këtë libër si krijimtari të tij artistike dhe të pavarur”.*

Gjatë zhvillimit të procedurave hetimore dhe nga komunikimi me Këshillin Bashkiak Lushnjë, Komisioneri, mori dijeni se Këshilli Bashkiak Lushnjë me Vendimin nr.46, datë 20.04.2018 ka anuluar V.K.B nr. 15, datë 26.01.2018 “Për përdorimin e fondit rezervë për librin “Dashuria e një jevge” dhe situata e krijuar, lidhur me mbështetjen financiare të një botimi që mund të promovonte përhapjen e shprehjeve stereotipe për komunitetin egjiptian, është zgjidhur dhe nuk ekziston më.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se me veprimet e kryera nga Këshilli Bashkiak Lushnjë, problematika e ngritur nga shoqata “Lëvizja Rinore Egjiptiane-Rome”, është zgjidhur dhe vlerëson se u arrit qëllimi për të cilin është nisur ky hetim në drejtim të mosfinancimit të librit me titull “Dashuria e një jevge”, titull i cili mund të përcillte tek lexuesi ndjenjën e urrejtjes ndaj komunitetin egjiptian në Shqipëri.

## **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germat a) dhe c), nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

1. Ndërprerjen e procedurave të hetimit dhe pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 35, datë 08.03.2018, të shoqatës “Lëvizja Rinore Egjiptiane-Rome”, pasi u arrit dhe qëllimi për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**Robert GAJDA**

---

**KOMISIONERI**